"2 N" SHPK

NIPT: L31615017L

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN

MENAXHIMI I MBETJEVE

ID 5.10/b **Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart.**

Referuar ligjit 108/2024 "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10448, DATË 14.7.2011, "PËR LEJET E MJEDISIT", TË NDRYSHUAR"

VENDNDODHJA

Tiranë, Babrru, nr.pasurie 100/120, Z.K 1066.

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1. PROFILI I OPERATORIT.....3

2. QËLLIMI I RAPORTIT.....4

3. OBJEKTIVAT E RAPORTIT.....5

4. VENDNDODHJA E AKTIVITETIT.....5

5. PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT.....7

6. IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I SHKARKIMEVE DHE NDIKIMEVE NË MJEDIS.....11

7. MASAT ZBUTËSE DHE PARANDALUESE TË NDIKIMEVE NË MJEDIS.....19

8. MONITORIMI.....22

1. PROFILI I OPERATORIT

Subjekti **"2 N"** është i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) me formë ligjore **Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SH.P.K.)**, me **NIPT L31615017L** dhe përfaqësohet ligjërisht nga administratori **Z. Ndriçim Stojku.**

TË DHËNAT E SUBJEKTIT SIPAS EKSTRAKTIT TË QKB:

Subjekti	2 N
Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	L31615017L
Data e Themelimit	15/04/2013
Data e Regjistrimit	15/04/2013
Forma ligjore	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tiranë, Paskuqan, Lagjia "Paskuqan Fushë", Rruga "Demokracia", Pallati Nr.2, Kati i Parë.
Administratori	Ndriçim Stojku

Sipas të dhënave të regjistruara në Ekstraktin e QKB-së, objekti i veprimtarisë së shoqërisë përfshin:

- *Zbatim, projektim e ndërtime civile, ekonomike, punime dheu, sistemin taracime, prodhime elementesh të parafabrikuara, betoni e beton arme dhe kompletimi me instalimet e nevojshme për to.*
- *Ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore etj.*
- *Ndërtim rrugë të kategorive të ndryshme veshje me asfalto beton të rrugëve /ndërtim mbishtresë/sistemim e asfaltim sheshi.*
- *Ndërtim vepra arti rrugore e hekurudhore, ndërtime ujësjellësa dhe kanalizime, sillosa, kulla, kulla uji, gurore, shfrytëzim minerale dhe lëndëve plasëse për përdorim civil.*
- *Prega beton armeje e metalike, punime karpenterie, rikonstruksione godinash civile e ekonomike, veshje fasadash, pastrim të superfaqes urbane.*
- *Prodhim inertesh, shfrytëzim e përpunim i materialit të shtratit të lumenjve.*
- *Import, eksport, tregtim me shumicë të mallrave të ndryshme industriale, ushqimore, pajisje elektrike, ushqimore, elektronike, elektrike, informatike, artikuj mobilerie, zyra, dyer, kancelari, pajisje ventilimi etj.*
- *Tregtim të materialeve të ndërtimit, import eksport.*
- *Prodhim dhe tregtim me shumicë dhe pakicë sisteme kamera sigurie, alarmi, kundra zjarrit, skelerie etj.*
- *Ndërtim autostrada dhe mbikalime të kategorive të ndryshme, barriera dhe mbrojtje rrugore, ndërtim urash, gazsjellësa, punime nëntokësore.*
- *Punime dhe mbrojtje lumore, pastrim i ujërave detare, liqenore dhe lumore.*
- *Ndërtim i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane.*
- *Sisteme hidraulike dhe bonifikime, vepra kullimi e vaditje.*
- *Ndërtim për N/stacionet dhe kabinat e transfomatorëve.*
- *Punime gërmimi.*

- *Punime për prishjen e ndërtimeve.*
- *Punime të inxhinierisë së mjedisit.*
- *Punime topogjeodezike.*
- *Punime strukturore speciale.*
- *Struktura kundër zhurmës për infrastrukturë.*
- *Punime, ndërtim lulishte, parqe, prerje e sisitemim pemësh e shkurre.*
- *Shërbim skelerie.*
- *Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, punime gipsi, shtrim pllakash, lyerje, hidroizolime etj.*
- *Blerje dhe shitje të produkteve dhe materialeve të ndryshme si edhe çdo aktivitet tjetër të lejuar me ligj.*
- *Vendosje e instalimeve elektrike.*
- *Pastrim rregullim i ambienteve të brendshme dhe të jashtme dhe sistemim - gjelbërim.*
- *Mbarështim pyjor, pyllëzime e përmirësime pyjore, mbarështim të faunës, mbrojtjen e pyjeve, mbarështim kullotash dhe livadhesh, gjelbërim qytetesh e parqesh kombëtare.*
- *Projektim, ndërtim, dhe rikonstruksion rrugësh pyjore.*
- *Ndërtimi I kapanoneve industriale të të gjitha llojeve.*
- *Gërmim, transport, grumbullim dhe përpunim dheu dhe mbetje të ndryshme ndërtimore dhe inerte, shtuf, urbane dhe jo të rrezikshme.*
- *Ndërtim vepra kullimi ujitje toke e impiante vaditëse.*
- *Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).*
- *Punime ndërtimore.*
- *Sinjalistikë rrugore jo ndriçuese si dhe sinjalistikë për njerëzit me aftësi të kufizuar, të verbër, shikim të ulët etj.*
- *Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.*
- *Punime Restaurime Ndërtime me karakter social kulturor dhe të kulteve të ndryshme fetare.*
- *Ndërtim fshatrash turistike.*
- *Transport I mallrave për të tretë dhe me qira dhe për llogari të vet brenda vendit.*
- *Import eksport, prodhim dhe tregtim fidanësh dhe lule dekorative.*
- *Mirëmbajtje objekte civile, industriale dhe të çdo lloji tjetër.*

2. QËLLIMI I RAPORTIT

Subjekti paraqet këtë raport me qëllim pajisjen me Leje Mjedisi të Tipit B për ushtrimin e aktivitetit, i cili klasifikohet:

ID 5.10/b	**Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart.**

Referuar shtojces 1 te ligjit 108/2024 "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10448, DATË 14.7.2011, "PËR LEJET E MJEDISIT", të ndryshuar

3. OBJEKTIVAT E RAPORTIT

1. Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedis (Emetimet në ajër, Gjenerimi i zhurmave; Ndikimi në florë/faunë; Mbetjet e gjeneruara; Ndikimi social-ekonomik; Ndikimi në cilësinë e jetës në qendrat e banuara; Ndikim në peisazhin e zonës).
2. Gjetja e alternativave që janë me miqësore me mjedisin dhe propozimi i masave të duhura për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme potenciale negative gjatë zbatimit të aktivitetit.
3. Lehtësimi i infomimit të publikut dhe organeve vendim-marrëse mjedisore, lidhur me zbatimin e aktivitetit.


4. VENDNDODHJA E AKTIVITETIT


Aktiviteti do të zhvillohet në adresën: **Tiranë, Babrru, nr.pasurie 100/120, Z.K 1066.**
Instalimi është i vendosur në një territor të përshtatshëm, i pajisur me infrastrukturë hyrëse/dalëse për transportin e materialeve.


Koordinatat e vendndodhjes se aktivitetit sipas Sistemit GAUSS KRUGER janë si më poshtë:

Nr.	X	Y
1.	4402799.03	4582187.64





Qarku
https://geoportal.asig.gov.al
Data e Printimit: 21.09.2026
DIBËR
DURRËS
"2 N" SHPK
TIRANË
ELBASAN
Legjenda
Rendi 2
2026
N
0 5 10 20 km
https://geoportal.asig.gov.al ofron të dhëna gjeohapësinore të ofruara nga autoritetet publike përgjegjëse.
Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e autoritetit publik që i ka krijuar ato.


Bashkia
https://geoportal.asig.gov.al
Data e Printimit: 21.09.2026
KRUJË
DURRËS
ZOGU
KAMEZ
"2 N" SHPK
SHIJAK
TIRANË
Legjenda
Rendi 3
2026
N
0 5 10 km
https://geoportal.asig.gov.al ofron të dhëna gjeohapësinore të ofruara nga autoritetet publike përgjegjëse.
Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e autoritetit publik që i ka krijuar ato.


Njësia Administrative
https://geoportal.asig.gov.al
Data e Printimit: 21.09.2026
"2 N" SHPK
Paskuqan
Legjenda
Rendi 4
2026
N
0 1 2 km
https://geoportal.asig.gov.al ofron të dhëna gjeohapësinore të ofruara nga autoritetet publike përgjegjëse.
Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e autoritetit publik që i ka krijuar ato.

5. PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT



Ky proces siguron menaxhimin e kontrolluar të mbetjeve, minimizon ndikimet në mjedis dhe garanton gjurmueshmërinë e plotë të rrjedhës së tyre deri në destinacionin përfundimtar.

1. **Pranimi i mbetjeve**

   Mbetjet pranohen në stacion e transferimit nga punonjësit përkatës. Në hyrje të objektit kryhet:

   - verifikimi i dokumentacionit shoqërues të ngarkesës;
   - kontrolli vizual i llojit të mbetjeve;
   - krahasim të dokumentacionit me mbetjen reale
   - regjistrimi i sasisë, origjinës dhe kodit të mbetjes sipas ***Vendimit Nr. 402, datë 30.06.2022 - Për miratimin e katalogut të mbetjeve.***
   - peshimi i mjeteve transportuese në hyrje dhe dalje, sipas nevojës.

2. **Shkarkimi dhe kontrolli**

   Pas verifikimit, mjetet drejtohen në zonat e dedikuara të shkarkimit. Shkarkimi kryhet duke përdorur mjete të posatshme, me staf të pajisur me PPE dhe në përputhje me procedurat e emergjencës.

   Gjatë këtij procesi kryhet:

   - inspektimi vizual për të identifikuar materiale të papranueshme;
   - ndarja paraprake sipas kategorive të mbetjeve.

3. **Ndarja dhe magazinimi i përkohshëm**

   Mbetjet do të ndahen dhe magazinohen përkohësisht sipas llojit të tyre (kategorisë) në zona të veçanta të shtruara dhe të identifikuara me sinjalistikë.

   - *Mbetje të ricikluesshme* - Këto materiale depozitohen në kontejnerë ose hapësira të dedikuara për riciklim.
   - *Mbetje drusore* - Magazinohen në zona të mbuluara për të shmangur lagështinë dhe degradimin.
   - *Mbetje ndërtimi dhe prishje* - Këto depozitohen në bokse të veçanta mbi sipërfaqe të papërshkueshme.
   - *Mbetje biodegradueshme* - Magazinohen në zona të dedikuara dhe transferohen në afate të shkurtra për të shmangur erërat dhe fermentimin.
   - *Mbetje të tjera jo të rrezikshme* - Magazinohen në kontejnerë të mbyllur dhe të etiketuar.
   - *Mbetje nga trajtimi i ujërave të ndotura* - Pranohen në rezervuarë ose kontejnerë hermetikë, duke parandaluar rrjedhjet dhe emetimet e pakontrolluara.

   Në fazën e ruajtjes (magazinimit), mbetjet depozitohen në hapësira të përcaktuara nga ana e subjektit, të ndara sipas kodeve.

   Zona e magazinimit mbahet e pastër dhe e kontrolluar, me masa për parandalimin e pluhurit, derdhjeve të pakontrolluara dhe ndotjes së tokës apo ujërave.

   Në këtë mënyrë, subjekti siguron që procesi i menaxhimit të mbetjeve të kryhet në mënyrë të sigurt, efektive dhe të qëndrueshme, duke respektuar standardet ligjore dhe mjedisore, duke mbrojtur mjedisin dhe duke kontribuar në shëndetin dhe sigurinë e komunitetit.

4. **Përgatitja për transport (tërheqje nga operator i licencuar/pritës final i mbetjeve)**
   Sipas llojit të materialit, mbetjet mund të:
   - ngarkohen drejtpërdrejt për transport;
   - grumbullohen deri në arritjen e sasive ekonomike të transportit;
   - paketohen, kompaktohen ose sistemohen për optimizimin e volumit.
5. **Transferimi dhe dorëzimi**
   Subjekti bashkëpunon me operatorë të licencuar për depozitim final mbetjesh. Në instalimin e pritësve finalë do të kryhen më tej operacionet e trajtimit/riciklimit ose asgjësimit final të mbetjeve.
   Pritësi final i mbetjeve, me të cilin është nënshkruar kontratë, disponon të gjitha lejet dhe autorizimet e nevojshme dhe e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.
   Transferimi I mbetjeve nga stacioni i transferimit të subjektit **"2 N" SHPK** shoqërohet me dokumentacionin përkatës dhe regjistrohet në sistemin e gjurmueshmërisë së mbetjeve.

   Procedura e dorëzimit të mbetjeve nga **"2 N" SHPK** tek **Operatorët final** përfshin:
   - Përgatitjen e mbetjeve në ambalazhim të duhur
   - Peshimin dhe llogaritjen e sasisë finale
   - Plotësimin e dokumentacionit të transferimit
   - Ngarkimin në mjetet e operatorit final
   - Regjistrimin e daljes në sistemin e operatorit

Për çdo lëvizje mbetjesh plotësohet:
- **Fletë shoqërimi të mbetjeve** (dokument transferimi) sipas VKM në fuqi
- **Regjistri i mbetjeve** (hyrje-dalje)

Në momentin që mbetjet do të ngarkohen në mjetet e destinuara për transportin e tyre, do të kryhet edhe plotësimi i **Dokumentit të transferimit për mbetjet jo të rrezikshme** *(referuar **VENDIM Nr. 229, datë 23.4.2014** - Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit (ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020).*

*Dokumenti i transferimit do të përmbajë **të paktën** informacionin e mëposhtëm:*

- *numrin unik të dokumentit të dorëzimit;*
- *emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të krijuesit të mbetjeve;*
- *emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të transportuesit të mbetjeve;*
- *emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të pritësit të mbetjeve;*
- *informacion për sasinë dhe tipin e mbetjeve, që transferohen dhe tipin e konteinerëve në të cilët ndodhet;*
- *vendin, kohën dhe datën e transferimit;*
- *përshkrimin e mbetjeve bashkë me listën e kodeve respektive;*
- *hollësi për trajtimet apo procese të tjera që mbetjet kanë pësuar deri në këtë çast.*

5.1. Menaxhimi i instalimit

Menaxhimi i stacionit të transferimit të mbetjeve realizohet nga personel i kualifikuar dhe i trajnuar për operimin, monitorimin dhe mirëmbajtjen e instalimit. Stafi përgjegjës disponon njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për garantimin e zhvillimit të sigurt, efikas dhe në përputhje me kërkesat teknike dhe mjedisore të aktivitetit.

Operatori i stacionit të transferimit ushtron aktivitetin në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e mbetjeve, duke respektuar kërkesat teknike, fiskale, tatimore, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit. Gjithashtu, zbatohen procedura të brendshme për pranimin, kontrollin, magazinimin e përkohshëm, transferimin e mbetjeve, si dhe për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe monitorimin e vazhdueshëm të aktivitetit.

Organizimi i punës bazohet në një strukturë të qartë organizative, e cila përcakton funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e secilit punonjës. Kjo strukturë mundëson koordinimin efektiv të proceseve operative, garantimin e gjurmueshmërisë së mbetjeve, rritjen e efikasitetit të punës dhe respektimin e standardeve të sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Hierarkia e menaxhimit dhe rrjedha e autoritetit përcaktohen në organogramën e shoqërisë, ku përgjegjësia e përgjithshme për administrimin dhe mbarëvajtjen e aktivitetit ushtrohet nga Administratori i kompanisë. Nën drejtimin e tij funksionojnë përgjegjësi i stacionit të transferimit, operatorët e pajisjeve, drejtuesit e mjeteve të transportit, personeli i ngarkim-shkarkimit dhe personeli mbështetës, sipas detyrave dhe kompetencave të përcaktuara.

Kjo strukturë organizative siguron funksionimin e rregullt të stacionit të transferimit, kontrollin dhe monitorimin e vazhdueshëm të flukseve të mbetjeve, respektimin e procedurave të pranimit dhe transferimit, si dhe zbatimin e kërkesave për sigurinë në punë, mbrojtjen e shëndetit publik dhe mbrojtjen e mjedisit.

ORGANOGRAMA



Përshkrimi i funksioneve

- *Administratori* – përgjegjës për drejtimin e përgjithshëm të aktivitetit dhe përputhshmërinë ligjore.
- *Drejtuesi teknik/Përgjegjësi i Stacionit të Transferimit* – organizon dhe mbikëqyr operacionet ditore, pranimin dhe transferimin e mbetjeve dhe monitoron zbatimin e masave të sigurisë në punë, mbrojtjes së shëndetit dhe mjedisit.
- *Operatorët e peshimit dhe regjistrimit* – kryejnë kontrollin, peshimin dhe dokumentimin e flukseve të mbetjeve.
- *Operatorët e ngarkim-shkarkimit* – operojnë pajisjet për lëvizjen dhe transferimin e mbetjeve.
- *Drejtuesit e mjeteve dhe transportit* – realizojnë transportin e mbetjeve drejt destinacioneve të autorizuara.
- *Personeli mbështetës dhe i mirëmbajtjes* – siguron mirëmbajtjen e pajisjeve dhe mbështetjen teknike të aktivitetit.

5.2. Lëndët e para dhe ndihmëse dhe energjia e përdorur

Aktiviteti i stacionit të transferimit të mbetjeve nuk përdor lëndë të para në kuptimin e proceseve prodhuese industriale, pasi funksioni i tij konsiston në pranimin, grumbullimin e përkohshëm dhe transferimin e mbetjeve drejt impianteve të trajtimit, riciklimit ose depozitimit të autorizuar.

Materiali kryesor që hyn në instalim përbëhet nga mbetje të gjeneruara nga aktivitete të ndryshme ekonomike ose shërbime publike. Pranimi i mbetjeve kryhet vetëm për llojet e autorizuara dhe shoqërohet me dokumentacionin e nevojshëm për identifikimin dhe gjurmueshmërinë e tyre. Prandaj mbetjet mund t'i kategorizojmë si lëndë e parë për këtë lloj aktiviteti.
Për funksionimin normal të stacionit përdoren materiale dhe produkte ndihmëse, të cilat përfshijnë:

- Energji elektrike për funksionimin e pajisjeve, sistemit të ndriçimit dhe infrastrukturës mbështetëse;
- Ujë për nevoja sanitare, pastrimin e sipërfaqeve.

LËNDË TË PARA	LËNDË NDIHMËSE	ENERGJIA E PËRDORUR
Mbetjet	Ujë	Energji Elektrike

Të gjitha materialet ndihmëse ruhen dhe përdoren sipas kërkesave teknike dhe procedurave të sigurisë, me qëllim minimizimin e ndikimeve në mjedis dhe garantimin e funksionimit të sigurt të stacionit të transferimit të mbetjeve.


6. IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I SHKARKIMEVE DHE NDIKIMEVE NË MJEDIS

RREZATIMI JONIZUES
Aktiviteti i stacionit të transferimit të mbetjeve nuk përfshin procese, pajisje apo teknologji që gjenerojnë rrezatim jonizues. Gjatë ushtrimit të aktivitetit nuk përdoren materiale radioaktive, burime rrezatimi apo pajisje që emetojnë rrezatim jonizues. Për rrjedhojë, nuk priten shkarkime, emetime apo ndikime në mjedis dhe në shëndetin e njeriut të lidhura me rrezatimin jonizues. Niveli i ndikimit nga ky faktor vlerësohet si i papërfillshëm ose zero.
VIBRACIONE
Gjatë funksionimit të stacionit të transferimit të mbetjeve mund të gjenerohen nivele të kufizuara vibracionesh, kryesisht nga lëvizja e automjeteve të transportit, përdorimi i pajisjeve të ngarkim-shkarkimit (si ekskavatorë, fadroma ose pajisje të ngjashme) dhe manovrimi i mjeteve brenda territorit të instalimit. Vibracionet e krijuara janë të karakterit lokal dhe të përkohshëm, duke u kufizuar kryesisht brenda perimetrit të stacionit. Për shkak të natyrës së aktivitetit, mungesës së proceseve të rënda industriale dhe përdorimit të pajisjeve standarde të transportit dhe manipulimit të mbetjeve, nivelet e vibracioneve nuk pritet të shkaktojnë ndikime të ndjeshme në mjedis, infrastrukturë apo në zonat përreth. Bazuar në natyrën e aktivitetit, ndikimi i vibracioneve vlerësohet si i ulët, lokal dhe i kontrollueshëm, pa efekte të rëndësishme në mjedis, shëndetin e punonjësve apo komunitetin përreth.
NDIKIMET NGA ZHURMAT
Gjatë funksionimit të stacionit të transferimit të mbetjeve, zhurma gjenerohet kryesisht nga lëvizja e automjeteve të transportit, gjatë ngarkim-shkarkimit të mbetjeve. Zhurma e gjeneruar është kryesisht e përkohshme dhe e kufizuar brenda zonës së aktivitetit. Duke marrë parasysh natyrën e procesit dhe masat e kontrollit të zbatuara, ndikimi akustik në mjedisin përreth pritet të jetë i ulët dhe brenda kufijve të lejuar nga legjislacioni në fuqi. *Subjekti do të respektojë vlerat e lejuara të zhurmave dhe do të funksionojë brenda fashës orare të përcaktuar në Udhëzimin e Përbashkët Nr.2, Datë 15.11.2023 "Për nivelin kufi të zhurmës për një mjedis të dhënë dhe për fushën e veprimtarive Ekonomike-Shoqërore".* **Vlerësimi i ndikimit:** Ndikim **i ulët deri në mesatar**, i kufizuar kryesisht brenda ambienteve të instalimit. Me zbatimin e mirëmbajtjes periodike të pajisjeve dhe masave organizative, aktiviteti nuk pritet të shkaktojë tejkalim të kufijve të lejuar të zhurmës në mjedisin përreth.
NDIKIMET NË KLIMË
Gjatë zhvillimit dhe operimit të aktivitetit, nuk priten ndryshime të ndjeshme në parametrat klimatikë të zonës, si temperatura mesatare, drejtimi dhe shpejtësia e erës, sasia apo intensiteti i reshjeve, apo lagështia relative e ajrit. Proceset e punës do të jenë të kufizuara në zonën e objektit dhe nuk do të ndikojnë në cirkulimin e masave ajrore apo në regjimin klimatik rajonal. Për më tepër, aktiviteti do të zhvillohet në përputhje me standardet mjedisore në fuqi, duke siguruar që çdo emetim potencial të jetë brenda kufijve të lejuar ligjorë.

Në përfundim, vlerësohet se aktiviteti nuk do të ketë as ndikim negativ dhe as pozitiv në klimën e zonës, duke ruajtur stabilitetin e kushteve ekzistuese klimatike.

NDIKIMET NË POPULLËSI

Aktiviteti i stacionit të transferimit do të zhvillohet brenda vijës së verdhë të zonës urbane të Paskuqanit, në Njësinë Strukturore KZ_B_BA1_5/8.



Ndikimet e mundshme në popullësi lidhen kryesisht me qarkullimin e automjeteve të transportit, zhurmën operative, emetimet e pluhurit. Megjithatë, këto ndikime pritet të jenë të kufizuara, të kontrollueshme dhe të karakterit lokal, pasi aktiviteti nuk përfshin procese trajtimi, përpunimi ose asgjësimi të mbetjeve, por vetëm grumbullimin e përkohshëm dhe transferimin e tyre.


Aktiviteti nuk pritet të shkaktojë ndikime të rëndësishme negative në shëndetin, sigurinë apo cilësinë e jetës së banorëve të zonës, për sa kohë që respektohen masat e parashikuara të menaxhimit dhe kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi. Përkundrazi, funksionimi i stacionit të transferimit kontribuon në përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve, rritjen e efikasitetit të shërbimit dhe mbrojtjen e mjedisit urban.

NDIKIMET NË UJËRA

*Zona ku zhvillohet aktiviteti ndodhet brenda pellgut ujëmbledhës të **basenit të Ishmit**. Referuar të dhënave të disponueshme në ASIG Geoportal, sipërfaqja e aktivitetit është e pozicionunar në distancë nga trupat ujor sipërfaqësor përkatësisht:*

- ***rreth 1.14 km nga Lumi i Tiranës;***
- ***rreth 1.38 km nga Liqeni i Zall-Herrit.***

Aktiviteti i stacionit të transferimit nuk përfshin procese industriale që përdorin ujë dhe nuk gjeneron shkarkime të drejtpërdrejta të ujërave teknologjike në mjedis. Megjithatë, ekziston mundësia e krijimit të ndikimeve të kufizuara në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore si pasojë e ujërave të reshjeve që bien në kontakt me mbetjet.



Për të parandaluar çdo ndikim të mundshëm në mjedisin ujor, do të zbatohen masat e mëposhtme:

- Shtrimi dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të papërshkueshme në zonat e operimit dhe magazinimit të përkohshëm;
- Mbledhja dhe kanalizimi i ujërave sipërfaqësore në mënyrë të kontrolluar;
- Pastrimi i rregullt i zonës së aktivitetit dhe largimi i menjëhershëm i mbetjeve të shpërndara;
- Respektimi i procedurave të menaxhimit të mbetjeve dhe kërkesave të legjislacionit mjedisor.

Duke marrë në konsideratë natyrën e aktivitetit, distancën nga trupat ujorë më të afërt dhe masat parandaluese që do të zbatohen, ndikimi në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore vlerësohet si i ulët, lokal dhe i kontrollueshëm. Aktiviteti nuk pritet të shkaktojë ndryshime të rëndësishme në cilësinë e ujërave apo në funksionimin e ekosistemeve ujore të zonës.

NDIKIMET NË AJËR

Ndikimet në ajër gjatë zhvillimit të aktivitetit lidhen kryesisht me qarkullimin e mjeteve të të ngarkim-shkarkimit brenda territorit të objektit. Gjatë funksionimit të tyre gjenerohen emetime gazesh nga procesi i djegies së karburantit dhe sasi të kufizuara të grimcave të imëta të pluhurit.


Për minimizimin e ndikimeve në ajër do të zbatohen masa si kufizimi i shpejtësisë së mjeteve brenda objektit, mirëmbajtja periodike e automjeteve dhe pajisjeve, si dhe mbajtja në gjendje të përshtatshme e sipërfaqeve të qarkullimit për të reduktuar formimin dhe shpërndarjen e pluhurit.

Vlerësimi i ndikimit: Duke marrë në konsideratë shkallën e aktivitetit, karakterin lokal të emetimeve dhe masat e kontrollit të parashikuara, ndikimi në cilësinë e ajrit vlerësohet i ulët, i përkohshëm dhe i kufizuar kryesisht brenda zonës së ushtrimit të aktivitetit.

NDIKIMET NË TOKË

Referuar hartës gjeologjike të gjeneruar nga ASIG Geoportal, zona ku zhvillohet aktiviteti është e vendosur mbi depozitime të periudhës së ***Tortonianit (Ni₃t),*** *të cilat përbëhen kryesisht nga ranorë, argjila dhe gëlqerorë litotamnikë.*

Këto formacione gjeologjike karakterizohen nga qëndrueshmëri e moderuar dhe përshkueshmëri e ndryshueshme, në varësi të përmbajtjes së argjilave dhe strukturës litologjike.



Në kushtet e aktivitetit të stacionit të transferimit të mbetjeve, nuk parashikohen ndërhyrje në strukturën gjeologjike të nëntokës. Ndikimet në tokë lidhen kryesisht me aktivitetet sipërfaqësore të operimit, si qarkullimi i mjeteve, ngarkim-shkarkimi dhe magazinimi i përkohshëm i mbetjeve.

Në përgjithësi, bazuar në natyrën e aktivitetit dhe karakteristikat gjeologjike të zonës, ndikimi në mjedisin tokësor vlerësohet si i kufizuar dhe i kontrollueshëm.


NDIKIMET MBI FLORËN DHE FAUNËN

Aktiviteti i stacionit të transferimit do të zhvillohet brenda vijës së verdhë të zonës urbane të Paskuqanit, në Njësinë Strukturore KZ_B_BA1_5/8.

Aktiviteti nuk parashikon shpyllëzim, heqje të vegjetacionit natyror apo ndryshim të përdorimit ekzistues të tokës.

Ndikimet e mundshme mbi florën dhe faunën lidhen kryesisht me shqetësimin e përkohshëm të faunës urbane nga zhurma dhe lëvizja e mjeteve. Këto ndikime janë të karakterit lokal, të përkohshme dhe të kontrollueshme, dhe nuk pritet të kenë ndikim domethënës në biodiversitetin e zonës përreth.

Në përfundim, ndikimi i aktivitetit në florë dhe faunë vlerësohet si i **ulët dhe lokal**, pa efekte të rëndësishme në biodiversitetin e zonës.




NDIKIMET E AKTIVITETIT TË ZHVILLIMIT MBI NDËRTIMET, TRASHËGIMINË ARKITEKTONIKE HISTORIKE DHE ZONAT E MBROJTURA

Aktiviteti që ushtron shoqëria zhvillohet në një zonë ku, si në sipërfaqe ashtu edhe në nëntokë, nuk evidentohen ndërtime me vlera të trashëgimisë arkitektonike apo historike, si dhe nuk janë të pranishme objekte me karakter arkeologjik apo kulturor.

Sipas verifikimeve gjeohapësinore të kryera në ASIG Geoportal, zona e aktivitetit ndodhet gjithashtu në distancë të konsiderueshme ajrore nga zonat e mbrojtura natyrore, konkretisht:

- rreth **3.39 km** nga **Parku Kombëtar Mali i Dajtit.**



Në këto kushte, aktiviteti i stacionit të transferimit të mbetjeve nuk ndikon drejtpërdrejt në integritetin e **zonave të mbrojtura natyrore**, për shkak të distancës së konsiderueshme dhe natyrës së kufizuar të ndikimeve lokale të aktivitetit.
Sa i përket **ndërtimit** dhe infrastrukturës përreth, ndikimet e mundshme lidhen kryesisht me rritjen e qarkullimit të automjeteve të transportit dhe përdorimin e hapësirave ekzistuese të urbanizuara. Këto ndikime vlerësohen si të kufizuara dhe të menaxhueshme, pa shkaktuar ndryshime strukturore në ndërtesat përreth.
Në lidhje me **trashëgiminë arkitektonike dhe historike,** bazuar në informacionet e disponueshme dhe karakterin urban të zonës, nuk identifikohen monumente kulture, objekte me vlera historike apo struktura të mbrojtura në afërsi të drejtpërdrejtë të aktivitetit. Për rrjedhojë, nuk parashikohen ndikime negative në trashëgiminë kulturore dhe historike.
Në përfundim, ndikimi i aktivitetit në ndërtimet përreth, trashëgiminë arkitektonike-historike dhe zonat e mbrojtura vlerësohet si **i** papërfillshëm deri i ulët, pa efekte të drejtpërdrejta apo të rëndësishme në këto aspekte mjedisore dhe kulturore.

MENAXHIMI I MBETJEVE

Menaxhimi i mbetjeve në stacionin e transferimit të mbetjeve do të realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe kushtet e përcaktuara në lejen përkatëse mjedisore. Aktiviteti konsiston në pranimin, magazinimin e përkohshëm dhe transferimin e mbetjeve drejt operatorëve të autorizuar.
Mbetjet pranohen vetëm nëse janë të shoqëruara me dokumentacionin përkatës që garanton gjurmueshmërinë e tyre, duke përfshirë kodet e mbetjeve sipas katalogut të mbetjeve dhe informacionin mbi origjinën e tyre. Nuk lejohet pranimi i mbetjeve jashtë kategorive të autorizuara.
Mbetjet që subjekti do të ruajë në stacionin e transferimit theksohet se do të grumbullohen të ndara sipas kategorisë.
Të gjitha mbetjet ruhen në ambientet e përshtatshme, të ndara sipas kodeve, me mbulesa mbrojtëse, shënime identifikuese.
Subjekti ka nënshkruar kontratë me operatorë të licensuar për depozitim final mbetjesh.
Pas dorëzimit të mbetjeve, operatori i licencuar merr përgjegjësi të plotë për transportin, trajtimin dhe/ose asgjësimin përfundimtar të tyre, në përputhje me kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi dhe kushtet e lejes përkatëse.

NDIKIMET E AKTIVITETIT NË RRUGËT LOKALE DHE TRANSPORTIN

Pranë vendndodhjes së aktivitetit kalon ***rruga Sado Kosheno,*** e cila shërben si aks kryesor hyrës dhe dalës për transportin e mbetjeve.
Kjo infrastrukturë rrugore mundëson qarkullimin normal të mjeteve të transportit, pa pasur nevojë për ndërhyrje apo zgjerime infrastrukturore.



Gjatë ushtrimit të aktivitetit nuk parashikohen ndryshime në rrjetin ekzistues të rrugëve lokale, pasi fluksi i mjeteve është i kufizuar, i planifikuar dhe i menaxhueshëm. Aktiviteti nuk ndikon në funksionimin e transportit publik apo privat të zonës dhe nuk pritet të shkaktojë rritje të ndjeshme të trafikut rrugor.

Ndikimet e mundshme në rrugët lokale lidhen kryesisht me rritje të përkohshme të pluhurit dhe ngarkesë të kufizuar në oraret e transportit. Këto ndikime janë të karakterit lokal dhe të kontrollueshëm.

Për minimizimin e ndikimeve, subjekti angazhohet për respektimin e kapaciteteve të mjeteve të transportit, kufizimin e shpejtësisë në segmentet rrugore lokale, si dhe mbulimin e ngarkesave për të shmangur shpërndarjen e materialeve gjatë transportit. Gjithashtu, parashikohet bashkëpunim me autoritetet vendore për mirëmbajtjen e segmenteve rrugore të përdorura nga aktiviteti, në funksion të garantimit të sigurisë dhe qarkullimit normal.

Ndikimi i aktivitetit në rrugët lokale dhe transport vlerësohet i ulët, i përkohshëm dhe i menaxhueshëm, pa efekte të konsiderueshme në infrastrukturën rrugore ekzistuese.

7. MASAT ZBUTËSE DHE PARANDALUESE TË NDIKIMEVE NË MJEDIS

Për të minimizuar dhe kontrolluar ndikimet e mundshme të aktivitetit të stacionit të transferimit të mbetjeve në mjedis dhe në komunitetin përreth, parashikohet zbatimi i një sërë masash zbutëse dhe parandaluese. Këto masa kanë për qëllim reduktimin e ndikimeve në komponentët kryesorë të mjedisit, sigurimin e një operimi të sigurt dhe të qëndrueshëm, si dhe përputhjen e plotë me kërkesat ligjore dhe standardet mjedisore në fuqi. Në vijim paraqiten masat konkrete që do të zbatohen gjatë fazës së funksionimit të aktivitetit.

MJEDISI TOKËSOR ***Qëllimi:*** *Parandalimi i ndotjes së tokës dhe mbrojtja e nëntokës nga derdhjet dhe rrjedhjet aksidentale dhe nga mbetjet.*
▪ Kryerja e të gjitha operacioneve brenda koordinatave dhe kufijve të miratuar; ▪ Kryerja e aktivitetit mbi sipërfaqe të sistemuara; ▪ Zbatimi i kushteve teknike dhe standardeve mjedisore; ▪ Mirëmbajtja periodike e automjeteve dhe pajisjeve për të shmangur rrjedhjet e lëndëve ndotëse; ▪ Magazinimi dhe menaxhimi i kontrolluar i mbetjeve sipas procedurave teknike dhe mjedisore për të shmangur çdo ndotje të tokës; ▪ Magazinimi i materialeve dhe pajisjeve vetëm në sipërfaqe të përcaktuara për të shmangur dëmtimin e shtresës së tokës; ▪ Disponueshmëria e materialeve absorbuese për ndërhyrje të menjëhershme në rast derdhjesh aksidentale; ▪ Pastrimi i rregullt i zonës së aktivitetit; ▪ Monitorimi periodik i gjendjes së sipërfaqeve operative dhe zbatimi i masave korrigjuese kur është e nevojshme.
CILËSIA E AJRIT ***Qëllimi:*** *Kontrolli dhe reduktimi i emetimeve të pluhrave, gazeve*
▪ Përdorimi i maskave mbrojtëse nga punonjësit për mbrojtjen e aparatit respirator; ▪ Mirëmbajtja periodike e automjeteve për të reduktuar emetimet e gazeve; ▪ Mjetet e transportit të mbahen fikur gjatë kohës së ngarkim–shkarkimit për të reduktuar emetimet; ▪ Kufizimi i shpejtësisë së mjeteve brenda territorit të stacionit; ▪ Pastrimi dhe mirëmbajtja e rregullt e sipërfaqeve operative; ▪ Organizimi i operacioneve të transferimit në mënyrë që të minimizohet koha e ekspozimit të mbetjeve.
MJEDISI UJOR ***Qëllimi:*** *Mbrojtja e ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë nga ndotja.*
▪ Parandalimi i çdo lloj shkarkimi ndotës në mjedisin ujor dhe në rrjetet kulluese natyrore; ▪ Mirëmbajtja e sipërfaqeve të papërshkueshme në zonat e operimit dhe magazinimit të përkohshëm;

▪ Pastrimi i rregullt i zonës së aktivitetit; ▪ Respektimi i procedurave të menaxhimit të mbetjeve dhe kërkesave të legjislacionit mjedisor.
MENAXHIMI I MBETJEVE ***Qëllimi:*** *Reduktimi dhe trajtimi i mbetjeve të gjeneruara, në mënyrë të kontrolluar.*
▪ Vendosja e kontenierëve të dedikuar brenda objektit për grumbullimin e mbetjeve; ▪ Diferencimi (Ndarja) dhe klasifikimi i mbetjeve sipas kodit dhe llojit; ▪ Ruajtja e përkohshme në kontenierë të përshtatshëm dhe të etiketuar; ▪ Parandalimi i përzierjes së mbetjeve të kategorive të ndryshme me njëra-tjetrën; ▪ Pastrimi i rregullt i zonës së stacionit për të shmangur shpërndarjen e mbetjeve; ▪ Dokumentim dhe raportim i saktë i mbetjeve të pranuara dhe të transferuara, për qëllime gjurmueshmërie dhe transparence; ▪ Tërheqja e mbetjeve të magazinuara në stacionet e transferimit vetëm nga operatorë të licensuar; ▪ Mbajtja e dokumentacionit shoqërues për çdo dorëzim të mbetjeve.
MENAXHIMI I NDOTJES AKUSTIKE (ZHURMAVE) ***Qëllimi:*** *Minimizimi i shqetësimeve akustike për komunitetin përreth.*
▪ Lëvizje e ngadaltë dhe e kujdesshme e mjeteve të transportit brenda zonës së aktivitetit. ▪ Vendosja e tabelave paralajmëruese dhe informuese rreth rregulloreve të zhurmës dhe sigurisë. ▪ Mirëmbajtja periodike e automjeteve për të siguruar funksionimin normal të tyre; ▪ Kufizimi i operacioneve në oraret e miratuara të punës; Orar pune i kufizuar në përputhje me normat për mbrojtjen nga zhurma (shmangia e orëve të natës). ▪ Organizimi i lëvizjes së mjeteve për të shmangur manovrat e panevojshme; ▪ Respektimi i kufijve të shpejtësisë brenda stacionit; ▪ Monitorim periodik i niveleve të zhurmës nga laboratorë të akredituar.
FLORA DHE FAUNA ***Qëllimi:*** *Ruajtja e florës dhe faunës së zonës, si dhe minimizimi i ndikimeve të aktivitetit mbi ekosistemin përreth.*
▪ Kufizimi i aktivitetit brenda sipërfaqes së miratuar të projektit; ▪ Ruajtja e brezave të gjelbër nëse ekzistojnë në zonën përreth; ▪ Menaxhimi i rregullt i mbetjeve për të shmangur tërheqjen e kafshëve endacake; ▪ Kufizimi i zhurmës dhe pluhurit për të reduktuar shqetësimin e faunës urbane; ▪ Mirëmbajtja e pastërtisë së zonës për të shmangur ndikimet indirekte në mjedisin përreth.
VIBRIMET ***Qëllimi:*** *Reduktimi dhe kontrolli i vibrimeve të krijuara nga aktiviteti, për të minimizuar ndikimet në mjedis, infrastrukturë dhe komunitetin përreth.*
▪ Mirëmbajtja periodike e automjeteve dhe pajisjeve të punës; ▪ Kufizimi i shpejtësisë së lëvizjes së mjeteve brenda stacionit; ▪ Përdorimi i rrugëve dhe sipërfaqeve të stabilizuara për qarkullimin e mjeteve;

▪ Organizimi i operacioneve të ngarkim-shkarkimit në mënyrë që të shmangen goditjet dhe manovrat e panevojshme.
NË KOMUNITETIN PËRRETH (populllësinë e zonës) ***Qëllimi:*** *Mbrojtja e shëndetit dhe cilësisë së jetës së komunitetit përreth, duke minimizuar shqetësimet dhe ndikimet e aktivitetit.*
▪ Organizimi i qarkullimit të automjeteve për të shmangur bllokimet dhe shqetësimet në trafikun lokal; ▪ Kufizimi i operacioneve brenda orareve të miratuara të punës; ▪ Mirëmbajtja e rregullt e pajisjeve dhe mjeteve të transportit për reduktimin e zhurmës dhe emetimeve; ▪ Pastrimi periodik i sipërfaqeve të punës dhe rrugëve të brendshme; ▪ Zbatimi i masave për kontrollin e pluhurave dhe aromave, sipas nevojës; ▪ Menaxhimi i mbetjeve në përputhje me procedurat teknike dhe mjedisore për të shmangur rreziqet për shëndetin publik.
TRAFIKU RRUGOR ***Qëllimi:*** *Garantimi i sigurisë rrugore dhe minimizimi i ndikimit të aktivitetit në qarkullimin lokal të automjeteve.*
▪ Planifikim i orareve të transportit për të shmangur oraret e pikut, për të mos shtuar ngarkesën rrugore lokale; ▪ Respektimi i normave të shpejtësisë të përcaktuara në Kodin Rrugor Shqiptar; ▪ Përdorimi i mjeteve të transportit në gjendje teknike të rregullt, me qëllim uljen e emetimeve, zhurmës dhe rrezikut në rrugë; ▪ Organizim i qarkullimit brenda stacionit për shmangien e bllokimeve; ▪ Sinjalistikë e qartë dhe menaxhim i hyrje-daljeve të automjeteve.

Zbatimi i këtyre masave siguron reduktimin e ndjeshëm të ndikimeve në mjedis dhe garanton funksionimin e aktivitetit në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet mjedisore në fuqi.

8. MONITORIMI

Qëllimi i monitorimit mjedisor është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

Plani i monitorimit në mjedis do të konsistojë në:
Do të kryhet monitorimin çdo 6 muaj për parametrat mjedisorë nga Laboratorë të Akredituar dhe do t'i raportojmë ato pranë Agjensisë Kombëtare të Mjedisit. Gjithashtu do të mbajmë edhe kopjet në subjekt dhe do t'ia vendosim në dispozicion inspektimeve që mund të ketë.

Nr.	Elementi i monitorimit	Frekuenca	KUSH?
1.	Monitorim i cilësisë së ajrit	Çdo 6 muaj	Laborator i Akredituar
2.	Monitorim i cilësisë së ujërave	Çdo 6 muaj	Laborator i Akredituar
3.	Monitorim i zhurmave	Çdo 6 muaj	Laborator i Akredituar
4.	Sasia e mbetjeve të gjeneruara	Në varësi të punës	Operatori
5.	Monitorim I gjendjes teknike të pajisjeve operuese	Çdo 1 vit	Operatori ose Teknikë të posatshëm

Të dhënat e monitorimit do të analizohen në mënyrë periodike për të siguruar që aktiviteti nuk tejkalon normat e lejuara mjedisore dhe për të garantuar funksionim të qëndrueshëm dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

"2 N" SHPK
Administrator
Ndriçim Stojku

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SH.P.K.
L31615017L
TIRANE-ALBANIA